



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 05, datë 14.04.2017

PËR

NDRYSHIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KAMËZ

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Kamëz, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kamëz, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Rregullorja e Planit;
 - b) Materiali hartografik;
2. Ngarkohet Bashkia Kamëz për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETAR I KKT
EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT